VENDIM
Nr. 61, datë 27.3.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "SOLAR HORIZON" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, ME KAPACITET PRODHUES 2 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1329/1prot., datë 20.3.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Solar Horizon' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Solar Horizon" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1329 prot., datë 13.3.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave ("a", "b" dhe "c"), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaron se nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullave të ERE-s, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit më 10.3.2025, sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave ("a", "b", "c" dhe "d"). Konkretisht, ai ka depozituar ekstraktin historik të regjistrit tregtar të vulosur elektronikisht nga QKB-ja, më datë 24.2.2025. Gjithashtu, aplikuesi ka dorëzuar në ERE vërtetimet e gjendjes gjyqësore të vulosura elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, më datë 24.2.2025, nga të cilat rezulton se si administratori i shoqërisë, ashtu edhe subjekti "Solar Horizon" sh.p.k., janë të padënuar. Rezulton se shoqëria ka depozituar si strukturën aktuale të funksionimit gjatë fazës së ndërtimit të projektit, ashtu edhe strukturën organizative që do të ketë pas licencimit dhe fillimit të prodhimit të energjisë elektrike.

- Në përputhje me pikën 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave ("a", "b" dhe "c"). Sipas germës "a" është depozituar vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Tiranë, datë 05.3.2025, që konfirmon se shoqëria "Solar Horizon" sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera tatimore dhe të sigurimeve shoqërore/shëndetësore, si dhe janë dorëzuar pasqyrat financiare për vitet 2021, 2022 dhe 2023, nga të cilat konstatohet se shoqëria nuk ka gjeneruar fitim gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, shoqëria ka depozituar një komunikim miratimi nga ProCredit Bank për një kredi e cila është ende në proces negociate, si dhe janë paraqitur pagesa të kryera ndaj kontraktorit për punime të projektit. Referuar planit të biznesit të depozituar në ERE,

rezulton se vlera e investimit është ndryshuar dhe shoqëria ka dorëzuar, gjithashtu, një kopje të kontratës së nënshkruar më datë 10.1.2024, midis "Solar Horizon" sh.p.k. (investitori) dhe "Kirac Green Energy" sh.p.k. (kontraktori), e cila parashikon realizimin e të gjitha punimeve për vënien në funksion të centralit, me të njëjtën vlerë si ajo e parashikuar në planin e biznesit. Në lidhje me ndryshimin e vlerës së investimit, në nenin 8.2 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, përcaktohet se: "mbajtësi i miratimit duhet të njoftojë për çdo ndryshim gjatë zbatimit të projektit". Shoqëria ka konfirmuar se e ka njoftuar MIE-n përmes shkresës së datës 30.12.2024, drejtuar MIE-s dhe AKBN-së, dhe se nuk ka marrë ndonjë kundërshti apo penalitet nga ana e tyre. Për sa i përket dokumentimit të aftësisë financiare për realizimin e projektit, referuar vlerës së re të investimit, janë dorëzuar në ERE dokumentet, si në vijim: për mbështetjen me kredi bankare (80% e investimit): kontrata e kredisë me "Procredit Bank" sh.a., e datës 27.12.2024, për ndërtimin e centralit fotovoltaik, si dhe konfirmimi i disbursimit të shumës nga banka, me shkresën e datës 19.2.2025. Për mbulimin e 20% të investimit nga vetë shoqëria: janë dorëzuar katër transaksione të kryera nga shoqëria "Solar Horizon" sh.p.k. në favor të "Kirac Energy" sh.p.k.

- Në përputhje me pikën 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave ("a", "b", "c", "d", "e" dhe "f"). Shoqëria ka depozituar formatin e plotësuar me të dhënat teknike për centralin fotovoltaik, përfshirë informacionet mbi kapacitetin dhe specifikimet teknike të pajisjeve. Nga ky informacion aplikuesi ka deklaruar se viti i ndërtimit të centralit është viti 2025, data e fillimit të operimit është qershor 2025, ndërsa jetëgjatësia e pritshme e centralit është 30 vjet.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- MIE dhe shoqëria "Solar Horizon" sh.p.k. kanë nënshkruar kontratën nr. 2427 rep., nr. 1572 kol., datë 28.4.2023, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria 'Solar Horizon'".

- OSSH sh.a. me shkresën nr. 11491/5 prot., datë 13.12.2024, ka miratuar pikën e lidhjes me rrjetin.

- Shoqëria është pajisur me vendimin për VNM paraprake, lëshuar më 17.7.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw dhe veprave ndihmëse.

- Rezulton se shoqëria ka një VNM të vlefshme deri në datën 17.7.2026 dhe në lidhje me fillimin e punimeve ajo ka depozituar në ERE përkatësisht shkresat e datës 14.1.2025, ku ka njoftuar institucionet përkatëse se data e fillimit të punimeve të centralit do të jetë 28.1.2025. Shoqëria vetë ka njoftuar se i ka filluar punimet brenda këtij afati, por vlerësohet që t'i kërkohet të depozitojë në ERE dokumentin përkatës, si p.sh. procesverbalin për fillimin e tyre, kjo me qëllim rakordimin e të gjitha akteve sa sipër cituar.

- Po ashtu, ERE do t'i drejtohet MIE-s, për t'u shprehur në rast se ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës nr. 2427 rep., nr. 1572 kol., datë 28.4.2023 dhe të drejtën e shoqërisë "Solar Horizon" sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike sipas kësaj kontrate.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe nenit 5, pika 1, germa "a", të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vlefshmëri deri në 30 vjet. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga vetë shoqëria përcaktohet se pajisjet e centralit do të kenë një garanci performance për të njëjtën periudhë, prandaj në rast licencimi, afati i vlefshmërisë së licencës do të jetë 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Solar Horizon" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Solar Horizon" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti